



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 7 në lidhje me nenin 77 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019), si dhe nenin 40 paragrafi 4 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), duke vepruar pas denoncimit nga parashtrues i njohur, në seancën e 46-të të mbajtur me datë 12.02.2021, KSHPK morri

VENDIM

Akuzat nga denoncimi për ekzistimin e konfliktit të interesave në procedurën për dhënje të autorizimit Shoqërisë së avokatëve nga ana e ish UD Drejtoreshës së IN , në kundërshtim me nenin 22 nga Ligji për parandalim të korrupsionit, kurse e dënuar sipas nenin 63 nga ligji i njëjtë, **janë të bazuara.**

Në përputhje me nenin 41 paragrafi 1 nga Ligji për kundërvajtje, procedura për kundërvajtje nuk mund të ngritet dhe as që të zhvillohet nëse kanë kaluar dy vite nga dita e kryerjes së kundërvajtjes dhe për shkak të ndryshimit të gjendjes faktike, gjegjësisht personi nuk e kryen më detyrën e UD Drejtoreshë në IN , procedura **NDËRPRITET.**

Në përputhje me Ligjin për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, KSHPK nuk ka elementet për veprim të mëtutjeshëm.

Procedura për lëndën 09-4182/1 me datë 05.09.2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

SQARIM

Lënda me numër 09-4282/1 me datë 05.09.2019 e formuar në bazë të Lajmërimit të marrë nga ana e UD Drejtoreshë e Institucionit nacional , kundër personit ish UD Drejtoreshë në institucionin e njëjtë, me akuza se e njëjta ka dhënë autorizim me numër 03-2098/10 me datë 14.12.2017 dhe autorizim me numër 03-406/1 me datë 29.03.2018 me të cilët e autorizon Shoqërinë e avokatëve ku si avokat paraqitet dhe njëherit si i punësuar bashkëshorti i saj Në bazë të autorizimit të dhënë me numër 03-208/1 me datë 14.12.2017 dhe autorizimit me numër 03-406/1 me datë 29.03.2018 nga ana e IN janë paguar dy fatura në bazë të veprimeve të ndërmarra.

Në denoncim, gjithashtu janë theksuar se shoqëria e njëjtë e avokatëve ka qenë e autorizuar edhe me autorizim numër 03-1337/3 me datë 30.10.2018, autorizim me numër 03-62/1 me datë 15.01.2019, autorizim me numër 03-63/1 me datë 15.01.2019 dhe autorizim me numër 03-64/1 me datë 15.01.2019, me të cilat kjo shoqëri avokatësh deri në momentin e parashtrimit të Lajmërimit nuk kanë dorëzuar faturë për pagesë. Sipas kësaj të theksuar, UD Drejtoreshë aktuale e ka tërhequr (anuluar) autorizimin me numër 03-406/1 me datë 29.03.2018.

KSHPK u drejtua deri tek IN , në lidhje me procedurat ku është e angazhuar shoqëria e përmendur e avokatëve, pas të cilës është dorëzuar dokumentacion plotësues nga ana e këtij institucioni.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga ana e IN, KSHPK vërtetoi se autorizimi me numër 03-2098.10 me datë 14.12.2017 dhe autorizimi me numër 03-406/1 me datë 29.03.2019 janë të nënshkruar nga personi ish UD Drejtoreshë në institucionin e njëjtë, në kundërshtim me nenin 22 nga Ligji për parandalim të korrupsionit. Me këto dispozita është e paraparë kufizim i personave të zgjedhur ose të emëruar, persoan zyrtar ose persona përgjegjës në ndërmarrje publike që mos të ken mundësi që gjatë kryerjes së funksionit të vet të krijojnë marrëdhënje afariste me persona juridik që janë themeluar nga persona të afërt familjarë, në të cilën person përgjegjës është anëtar i familjes së vet. Në përputhje me nenin 63 nga Ligji për parandalim të korrupsionit janë të parapara dispozita dënuese për shkelje të kufizimeve të sipërpërmendura, mirëpo nga ana tjetër në përputhje me nenin 41 paragrafi 1 nga Ligji për kundërvajtje, procedura për kundërvajtje nuk mund të ngritet dhe as që të zhvillohet nëse ka kaluar dy vite nga dita e kryerjes së kundërvajtjes. Shkejla ka ndodhur në momentin kur ish UD Drejtoresha e UD, ka nënshkrua autorizimin me numër 03-2098.10 me datë 14.12.2017 dhe autorizimin me numër 03-406/1 me datë 29.30.2018.

Në përputhje me të theksuarën më sipër dhe akuzat e vërtetuara, si dhe për shkak të ndryshimit të gjendjes faktike, gjegjësisht personi nuk e kryen më funksionin e UD Drejtoreshë në IN, KSHPK në seancën e 46-të, konstaton se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm.

KOMISIONI SHITETËROR PËR
PARANDALIM TË KORRUPSIONIT
Kryetarë: Biljana Ivanovska

Pas përfundimit të KSHPK
Përpunoi: K. Z. – këshilltarë
Miratoi: S. P. D., anëtar i KSHPK.